

TERMA REFERENCE

KONKURS KOMBËTAR

PËR

“Hartim Projekti –

**Kullat e Vrojtimit në rrjetin
e zonave të mbrojtura:”**

**– Inteligjenca Natyrale, Artificiale &
Kolektive**

LËNDA

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

- 1.1. TË DHËNA MBI KULLAT E VROJTIMIT TË PROPOZUARA SIPAS ADZM-VE NË TERRITORIN E ZONAVE TË MBROJTURA
- 1.2. HARTA ME VENDNDODHJET E PROPOZUARA
- 1.3. INFORMACION MBI STUDIMIN

2. QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE NDIKIMI I PRITSHËM

- 2.1. QËLLIMI
- 2.2. OBJEKTIVAT
- 2.3. NDIKIMI I PRITSHËM
- 2.4. KUADRI LIGJOR

3. METODOLOGJIA E PUNËS, KRITERET E KONKURSIT DHE DOKUMENTAT PËR DORËZIM

- 3.1. METODOLOGJIA
- 3.2. KRITERET E KONKURSIT
- 3.3. DOKUMENTAT PËR DORËZIM

4. REALIZIMI I STUDIMIT

- 4.1. PLANIFIKIMI DHE DORËZIMET
 - 4.1.1 Periudha e fillimit
 - 4.1.2 Periudha e përfundimit e parashikuar ose kohëzgjatja
 - 4.1.3 Planifikimi - përfshirë periudhën e njoftimit
- 4.2. RAPORTIMI
 - 4.2.1. Përmbajtja, gjuha, paraqitja/ afati i komenteve, numri i kopjeve të raportit
- 4.3. MONITORIMI DHE VLERËSIMI
 - 4.3.1. Përcaktimi i treguesve
 - 4.3.2. Angazhimi gjatë implementimit
 - 4.3.3. Lehtësirat për Fituesit e Projektit dhe Aksesit në Informacion
 - 4.3.4. Takimet teknike dhe mes palëve të interesuara
 - 4.3.5. Transferimi i njohurisë
 - 4.3.6. Konfidencialiteti

5. REFERENCA | SHTOJCA

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

1.1 TË DHËNA MBI PIKAT E PROPOZUARA SIPAS ADZM-VE NË TERRITORIN E ZONAVE TË MBROJTURA

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është institucioni përgjegjës për administrimin dhe monitorimin e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri, të cilat zënë rreth 21.4% të territorit kombëtar. Këto zona, së bashku me rrjete të tjera ekologjike si Natura 2000, administrohen në përputhje me Ligjin nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar dhe planet përkatëse të menaxhimit.

Ky kuadër ligjor synon të garantojë planifikimin, konservimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe biologjike, si dhe të mbështesë zhvillimin e turizmit mjedisor, edukimin e publikut dhe gjenerimin e përfitimeve sociale e ekonomike për komunitetet vendore dhe aktorët publikë e privatë.

Rrjeti përfshin 11 parqe kombëtare, 1 park kombëtar detar, 24 rezervate natyrore të menaxhuara/parqe natyrore, 10 peizazhe të mbrojtura dhe 724 monumente natyre, të cilat përfaqësojnë vlerat më të spikatura natyrore dhe të biodiversitetit në vend. Interesi në rritje për këto zona, si nga qytetarët vendas ashtu edhe nga turistët e huaj, dëshmon rëndësinë e tyre si destinacione rekreative, edukative dhe kulturore.

Turizmi në zonat e mbrojtura është bërë një ndër shtyllat më të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm në territorin shqiptar, duke sjellë rritje të ndjeshme të numrit të vizitorëve vit pas viti. Zonat e mbrojtura ofrojnë një alternativë të veçantë për turizmin natyror, larg strukturave masive e komerciale, duke promovuar vlerat e peizazhit, biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore. Ky interes gjithnjë në rritje sjell me vete sfida të reja për menaxhimin e këtyre zonave, përfshirë nevojën për krijimin e infrastrukturës minimale që lehtëson aksesin, orientimin dhe përjetimin cilësor të natyrës.

Në këtë kontekst, është identifikuar nevoja për ngritjen e kullave të vrojtimit në pika të zgjedhura të territorit të zonave të mbrojtura, të cilat ofrojnë lehtësira për të përjetuar pamjet domethënëse, vlerat peizazhore të veçanta dhe potencialin për interpretim mjedisor. Kullat e Vrojtimit janë struktura të lehta, me ndikim minimal në mjedis, që u mundësojnë vizitorëve të përjetojnë natyrën në mënyrë të sigurt, të orientuar dhe të ndërgjegjshme. Këto struktura kanë funksion të shumëfishtë: rrisin vlerën turistike të destinacionit; ndihmojnë në monitorimin e biodiversitetit; nga lart ofrojnë pamje të gjerë për vrojtimin e faunës (p.sh. shpendëve, kafshëve), interpretimin e natyrës. Ndihmojnë në vlerësimin e shëndetit të ekosistemeve, menaxhimin e fluksit të vizitorëve duke i kanalizuar drejt pikave të përcaktuara; ofrojnë një mjet interpretimi dhe edukimi mjedisor; si dhe kontribuojnë në ndërgjegjësimin për ruajtjen e vlerave natyrore përmes përjetimit të drejtpërdrejtë dhe të organizuar të peizazhit.

Projekti do të mbështetet në të dhënat e mbledhura nga Administratat e Zonave të Mbrojtura (AdZM-të), me qëllim vlerësimin e nevojave në terren dhe përcaktimin e vendndodhjeve më të përshtatshme për ndërtimin e kullave të vrojtimit duke respektuar parimet e ruajtjes, estetikës dhe qëndrueshmërisë. Në vijim paraqiten pikat

FAQE | 3

panoramike të propozuara nga AdZM-të, të ndara sipas qarqeve përkatëse. Këto pika janë identifikuar si vende me vlera të larta peizazhore, pamje të spikatura dhe potencial për ngritjen e strukturave të lehta të tipit ballkon panoramik, me funksione vëzhgimi, pushimi dhe interpretimi mjedisor:

Qarku Elbasan:

Në Parkun Kombëtar Shebenik, në zonën e Rrajcës (vendi Ruen), është e nevojshme vendosja e një kulle vrotimi me koordinatat gjeografike sipas UTM: N 41 08 33.86; E 20 3450.26. Kjo është një pikë dominante që do të shërbejë për vrotimin e zjarreve, shpendëve, si dhe për vizitorët që preferojnë të shikojnë peizazhe natyrore të parkut dhe zonën UNESCO të pyjeve madhështore të Rrajcës

Qarku Shkodër:

Në Rezervatin Natyror të Menaxhuar Liqeni i Shkodrës, është e nevojshme vendosja e një kulle vrotimi në zonën e liqenit të Shkodrës, në kufi me Malin e Zi, me koordinatat gjeografike sipas UTM: 365081.14 m E; 4635112.75 m N.

Qarku Tiranë:

Në Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit" është e nevojshme vendosja e një kulle vrotimi në Majën e Tujanit me koordinatat gjeografike sipas UTM: 409177E; 4581211N. Kjo kullë vrotimi do të shërbejë për monitorimin e zjarreve dhe të faunës së egër përgjatë vitit.

Qarku Vlorë:

Në Lagunën e Nartës, në Peizazhin e Mbrojtur "Pishë Poro", është e nevojshme vendosja e një kulle vrotimi për vëzhgimin e shpendëve (birdwatching) me koordinatat gjeografike sipas UTM: 40 33 32 N; 19 26 05 E.

Qarku Berat:

Në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit", për shkak të rritjes së numrit të vizitorëve, është e nevojshme vendosja e një kulle vrotimi në fshatin Kapinovë, me koordinatat gjeografike sipas UTM: 426127.67 m E; 4500039.68 m N. Kjo kullë do të shërbejë për monitorimin e zjarreve në pyje dhe kullota për shkak të pozicionit të saj të favorshëm.

Qarku Durrës:

Në Parkun Natyror Qafështamë, është e nevojshme vendosja e një kulle vrotimi në pikën Qafa e Mafsheqit me koordinatat gjeografike sipas UTM: 399219 m E; 4601692m N. Kjo është një pikë dominante me fushëpamje të gjerë për monitorimin e zjarreve dhe për turistët.

Qarku Gjirokastrë:

Në Parkun Kombëtar "Bredhi i Hotovës – Dangëlli" është e domosdoshme ngritja e një kulle vrotimi në vendin e quajtur Kokojka e Frashërit, me koordinatat gjeografike sipas UTM: 5352 82 E; 44 68 11.9 N. Në Parkun Natyror "Zagori" është e domosdoshme ngritja e një kulle vrotimi në vendin e quajtur Kisha e Kristoforit, me koordinatat gjeografike sipas UTM: 51 73 71 E; 44 58 76.9 N

Qarku Dibër:

Në Parkun Kombëtar "Lurë – Mali i Dejës", në Majën e Gjemes, me koordinatat gjeografike sipas UTM: 51 73 71 E; 44 58 76.9 N, është e domosdoshme ngritja e një kulle vërtetimi. Do të shërbejë jo vetëm për rastet e zjarrit, por edhe për monitorimin e vazhdueshëm të faunës së egër në zonat e mbrojtura gjatë gjithë vitit.

Qarku Korçë:

Në Parkun Kombëtar Prespë është e domosdoshme vendosja e dy kullave vërtetimi në pikat me koordinatat gjeografike sipas UTM: 577109.17 m E; 4528441.92 m N. Në Peizazhin e Mbrojtur Ujor Tokësor "Liqeni i Pogradecit" është e domosdoshme vendosja e një kulle vërtetimi në pikën me koordinata gjeografike sipas UTM: 578048.369 m E; 4515024.971 m N.

Qarku Kukës:

Në Parkun Natyror "Korab – Koritnik", në afërsi të liqenit të Kallabakut, aty ku fillon Shtegu i Ngjyrrave dhe maja e Gjallicës, të cilat janë atraksione turistike që vizitohen gjatë gjithë vitit, është e domosdoshme vendosja e një kulle vërtetimi me koordinata gjeografike sipas UTM: 464752 m E; 4644343 m N.

Qarku Lezhë:


Në Rezervatin Natyror i Menaxhuar "Kune-Vain-Patok-Fushëkuqe- Ishëm", në Lagunën e Patokut, e cila është një pike turistike shumë e vizituar është e nevojshme vendosja e një kulle vërtetimi me koordinata gjeografike sipas UTM:

1.2 HARTA ME VENDNDODHJET E PROPOZUARA

Tab. 1. Paraqitja me koordinata të pikave të propozuara për kullat e vërtetimit.

Qarku	Zona e Mbrojtur	Koordinata	Vendodhja gjeografike
Berat	Parku Kombëtar Mali i Tomorrit	40°38'52.47"N 20°7'34.56"E	Fshati Kapinovë
Dibër	Parku Kombëtar Lurë-Mali i Dejës	41°48'38.89"N 20°15'9.38"E	Maja e Gjemës
Durrës	Parku Natyror Qafështamë	41°33'38.00"N 19°47'29.00"E	Qafa e Mafsheqit
Elbasan	Parku Kombëtar Shebenik	41°19'30.5"N 20°27'19.4"E	Çerenec
Fier	Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta	40°57'34.21"N 19°28'17.31"E	Kanali i Vaut
Gjirokastër	Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës – Dangëlli	40°20'48.8"N 20°24'56.7"E	Kokojska e Frashërit
Korçë	Peizazh Ujor Tokësorë i Mbrojtur Liqeni i Pogradecit	40°54'26.1"N 20°43'46.9"E	Tushemisht, Pogradec
Kukës	Parku Natyror Korab-Koritnik	41°56'59.0"N 20°34'30.6"E	Liqeni i Kallabakut

Lezhë	Rezervati Natyror i Menaxhuar 'Kune-Vain-Patok-Fushëkuqe-Ishëm"	41°37'39.7"N 19°36'30.3"E	Laguna e Patokut
Shkodër	Parku Kombëtar Alpet e Shqipërisë	41°51'23.13"N 19°22'28.43"E	Velipojë
Tiranë	Parku Kombëtar Mali i Dajtit	41°22'38.27"N 19°54'49.93"E	Maja Tujanit
Vlorë	Peizazh i Mbrojtur Pishë-Poro	40°33'39.4"N 19°25'11.5"E	Laguna e Nartës



Harta e pozicionimit të pikave të propozuara për kullate vrojtimit.

1.3 INFORMACION MBI STUDIMIN

Sektori i turizmit po konsolidohet gjithnjë e më shumë si një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, i mbështetur në politika kombëtare dhe në një rritje të qëndrueshme të fluksit turistik. Një nga format më të qëndrueshme dhe me ndikim pozitiv është turizmi natyror, i cili zhvillohet në përputhje me vlerat ekologjike dhe kulturore të territorit.

Zonat e mbrojtura natyrore në Shqipëri ofrojnë një gamë të gjerë mundësish për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, duke përfshirë turizmin rural, malor, liqenor, ligatinor dhe detar, si dhe aktivitete rekreative në natyrë si ecja, çiklizmi malor, rafting, ngjitjet alpinistike, shëtitjet me kuaj, vizitat edukative e shkencore, etj. Shumë prej këtyre aktiviteteve përbëjnë motivin kryesor të vizitave nga turistët ndërkombëtarë. Në vitin 2024, zonat e mbrojtura u vizituan nga mbi 5.5 milionë vizitorë, çka përforcon nevojën për ndërhyrje të menaxhuara dhe përmirësime infrastrukturore që nuk cenojnë integritetin e mjedisit.

Megjithëse këto zona kanë potencial të lartë për zhvillim turistik, mbeten ende të nevojshme orientime të qarta dhe ndërhyrje të kujdesshme për të kanalizuar zhvillimin në përputhje me politikat kombëtare, vizionin ndërkombëtar për turizmin e qëndrueshëm dhe parimet e ruajtjes së natyrës. Këto orientime duhet të ndërthuren me funksionet e territorit, tiparet e tij ekologjike dhe gjuhën e arkitekturës së peizazhit, në mënyrë që zhvillimi të jetë harmonik dhe afatgjatë.

Në këtë kuadër, ky projekt synon të hartojë një koncept arkitektonik për ndërtimin e kullave të vrojtimit në zona të përzgjedhura brenda territorit të zonave të mbrojtura. Qëllimi është krijimi i strukturave të integruara në mjedis, të cilat përmirësojnë përvojën e vizitorëve përmes përjetimit vizual të peizazhit, informimit mjedisor dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë natyrore.

Kullat e vrojtimit do të projektohen si elementë me ndikim të ulët në mjedis por me vlerë të lartë funksionale dhe estetike. Ato mundësojnë:

- Rritjen e aksesit dhe sigurisë për vizitorët e të gjitha grupmoshave;
- Nxitjen e edukimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor, përmes elementëve interpretues dhe dizajnit të informuar;
- Krijimin e përvojave të plota turistike, të bazuara në bashkëjetesë me natyrën;
- Kontributin në zhvillimin ekonomik lokal, nëpërmjet rritjes së qëndrueshme të vizitueshmërisë dhe ndërveprimit me komunitetin.

Këto struktura nuk janë thjesht pika vrojtimi – ato përfaqësojnë porta të hapura drejt një përvoje të thellë dhe të ndërgjegjshme me natyrën. Ato u ofrojnë vizitorëve mundësinë për të kuptuar më mirë vlerat ekologjike, kulturore dhe historike të zonave të mbrojtura, duke shërbyer si ura lidhëse mes njeriut dhe mjedisit. Përmes dizajnit të tyre të kujdesshëm dhe funksionalitetit të shumëfishtë, kullat e vrojtimit bëhen pika

referimi për edukim, reflektim dhe përjetim të natyrës në mënyrë të qëndrueshme dhe të respektueshme.

Ndikimet e mundshme negative gjatë zbatimit të projektit (të përkohshme):

- Ndotja e përkohshme e territorit gjatë fazës së ndërtimit (zhurma, mbetje ndërtimore, ndërhyrje fizike);
- Shqetësimi i faunës së egër për shkak të aktivitetit njerëzor dhe pajisjeve gjatë zbatimit.

Këto ndikime do të vlerësohen dhe minimizohen përmes masave të përshtatshme planifikuese dhe teknike, duke siguruar që ndërhyrjet të realizohen në harmoni me objektivat e ruajtjes dhe integritetit të zonave të mbrojtura.

2. QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE NDIKIMI I PRITSHËM

2.1 QËLLIMI

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), si autoriteti i këtij projekti, ka për detyrë administrimin, ruajtjen dhe zhvillimin e zonave të mbrojtura në territorin e Shqipërisë. AKZM është themeluar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 102, datë 4.2.2015, dhe vepron në varësi të ministrit përgjegjës. Duke funksionuar si Drejtoria e Përgjithshme në nivel qendror dhe në bazë qarku në nivel vendor, AKZM ka për detyrë monitorimin dhe kontrollin e zonave të mbrojtura në përputhje me legjislacionin shqiptar, bazuar në Ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar. Ky konkurs kombëtar fton brezin e ri të arkitektëve të imagjinojnë kulla vrojtimi për Zonat e Mbrojtura të Shqipërisë — struktura që shkojnë përtej funksionit të vëzhgimit, duke u bërë ndërfaqe midis kujdesit njerëzor dhe inteligjencës ekologjike. Konkursi synon të zbatojë në praktikë filozofinë e inteligjencës natyrore, artificiale dhe kolektive, brenda kontekstit shqiptar të zonave të mbrojtura malore, pyjore dhe bregdetare.

2.2 OBJEKTIVAT

Ky projekt synon:

Studimin e terrenit ku janë percaktuar për tu zhvilluar këto struktura në zonat e mbrojtura; Propozimin arkitektonik për ndërtimin e kullave të vrojtimit në territoret e mbrojtura bazuar në karakteristikat specifike të çdo zone të mbrojtur;

Studentët do të kuptojnë arkitekturën jo vetëm si formë apo estetikë, por si sistem të gjallë që bashkëvepron me natyrën dhe komunitetin. Përmes këtij konkursi, pjesëmarrësit do të eksplorojnë mënyra të reja të menduarit mbi ekosistemet natyrore (inteligjencë natyrore), teknologjinë e monitorimit (inteligjencë artificiale) dhe përfshirjen njerëzore (inteligjencë kolektive).

Objektivat specifike të projektit përfshijnë:

- Verifikimin në terren dhe vlerësimin teknik të pikave të propozuara nga AdZMtë, duke marrë në konsideratë vlerat peizazhore, qasjen, sigurinë, integritetin ekologjik dhe mundësinë për ndërhyrje të qëndrueshme arkitektonike;
- Projektimin e Kullave të vrojtimit në vendndodhjet e përzgjedhura, duke respektuar tiparet natyrore, topografike dhe vizuale të secilës zonë, në përputhje me standardet e ndërtimit në mjedise të mbrojtura;
- Zgjedhjen dhe rekomandimin e materialeve ndërtimore ekologjike dhe të përshtatshme për mjedisin, për të siguruar ndërhyrje jetëgjata, funksionale dhe estetike të harmonizuara me natyrën;
- Përdorimin e teknologjive bashkëkohore, si softuer GIS dhe pajisje të tjera për hartëzimin, dokumentimin dhe përgatitjen e modeleve vizuale (render, volume 3dimensionale dhe simulime 3D) të strukturave të propozuara;
- Parashikimin e elementeve të interpretimit dhe edukimit mjedisor, përmes dizajnit të integruar informativ dhe ndërveprues, që i ofron vizitorëve një përvojë të pasur dhe ndërgjegjëse për vlerat e natyrës;

2.3 NDIKIMI I PRITSHËM

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka nisur punën për **Hartimin e projektit për Kullat e vrojtimit në rrjetin e zonave të mbrojtura: inteligjenca natyrale, artificiale, kolektive**", si pjesë e përpjekjeve për të rritur cilësinë e infrastrukturës interpretuese dhe përvojës së vizitorëve në territoret natyrore me vlera të larta mjedisore.

Zbatimi i këtij projekti pritet të ketë ndikim pozitiv në rritjen e kapacitetit për monitorimin e vazhdueshëm të faunës së egër dhe mbrojtjen e biodiversitetit në Zonat e Mbrojtura. Projekti do të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin e infrastrukturës së vrojtimit, duke krijuar kushte më të mira për monitorimin e shpendëve dhe aktiviteteve të tjera të lidhura me ruajtjen e natyrës.

Zbatimi i këtij projekti pritet të sjellë një sërë ndikimesh pozitive, duke përfshirë:

- Krijimin e një harmonie funksionale dhe vizuale midis mjedisit natyror dhe ndërhyrjeve arkitektonike, duke ofruar hapësira të organizuara për përjetimin e natyrës dhe vëzhgimin e peizazheve karakteristike;
- Rritjen e aksesueshmërisë dhe sigurisë për të gjitha grupmoshat, përmes ndërtimit të strukturave të përshtatshme, të qëndrueshme dhe të qarta në funksionin e tyre për orientim dhe ndalim;

- Mbështetjen e edukimit dhe ndërgjegjësimi mjedisor, nëpërmjet elementëve informues dhe dizajneve të kujdesshme, që u ofrojnë vizitorëve një eksperiencë të ndërgjegjshme dhe respektuese ndaj natyrës;
- Zgjerimin dhe diversifikimin e ofertës turistike të zonave të mbrojtura, në përputhje me parimet e turizmit të qëndrueshëm dhe me kërkesat e tregut bashkëkohor për përjetime autentike dhe të strukturuar në natyrë;
- Kontributin në zhvillimin lokal, përmes rritjes së qëndrueshme të vizitueshmërisë, krijimit të mundësive të reja për ofruesit lokalë të shërbimeve dhe nxitjes së bashkëpunimit me komunitetet vendore;
- Forcimin e rolit të zonave të mbrojtura si hapësira për edukim, rekreacion dhe zhvillim të qëndrueshëm, duke ndihmuar në përmbushjen e objektivave strategjike kombëtare për integrimin e mbrojtjes së natyrës me zhvillimin ekonomik.

2.4 KUADRI LIGJOR

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet implementimi i këtij projekti, e cila mundëson realizimin e proceseve që do të realizohen:

- Ligji nr. 81/2017 "Për zonat mbrojtura", i ndryshuar – Ky ligj rregullon të gjitha aspektet që lidhen me zonat e mbrojtura në Shqipëri. Ligji përcakton kategoritë e ZM, rregullat dhe rolet për menaxhimin e tyre dhe vendimmarrjen. Ligji kërkon zbatimin e këtyre rregullave në rast të ndërmarrjes së projekteve brenda territorit të ZM;
- Planet e menaxhimit për Zonat e Mbrojtura.
- VKM nr. 187, datë 25.03.2021. VKM përcakton listën e monumenteve të natyrës në vend, monumentet janë kategori e Zonave të Mbrojtura dhe si të tilla duhet të mbrohen nga dëmtimi;
- Ligji Nr. 93/2015 "Për turizmin;
- Ligji Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".

3. METODOLOGJIA, DOKUMENTAT PËR DORËZIM DHE FAZIMI I PUNËS

3.1. METODOLOGJIA

Studentët thirren nëpërmjet kësaj thirrjeje për të asistuar Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), bazuar në Ligjin Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar, si dhe në përputhje me prioritetet zhvillimore të AKZM-së për vitin 2024.

Studentet do të punojnë ngushtësisht me stafin e AKZM-së përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit. Në mbështetje, do të ngrihet një Grup pune për të koordinuar procesin për hartimin e projektit, i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin, vlerësimin e procesit, koordinimin dhe bashkërendimin e tij, sikurse edhe të produkteve që do të dalin prej tij dhe do të mbështesë të gjitha palët e përfshira në proces për t'u njohur dhe familiarizuar me detyrimet ligjore që rrjedhin nga detyra.

Hartimi i Projektit “**Kullat e Vrojtimit në rrjetin e zonave të mbrojtura: – Inteligjenca Natyrale, Artificiale & Kolektive**” duhet të ndjekë metodologjinë me fazat si më poshtë:

1. Faza e identifikimit dhe vlerësimit të dëmtimit

- Verifikim në terren dhe analizë e të dhënave të siguruara nga AdZM-të (lokacionet e propozuara për vendosjen e kullave);
- Dokumentim fotografik dhe grafik i vendndodhjeve të identifikuara;
- Vlerësim i karakteristikave të terrenit, aksesueshmërisë, vizibilitetit panoramik dhe kushteve të stabilitetit për ndërtim;
- Përzgjedhja dhe klasifikimi i pikave për zhvillim të mëtejshëm të projektit.

2. Analiza teknike, peizazhore dhe mjedisore

- Vlerësimi i ndikimeve vizuale dhe integrimi i strukturave në peizazh;
- Përcaktimi i kufizimeve mjedisore në përputhje me statusin e mbrojtjes; – Përlogaritja e nevojave për ndërhyrje strukturore dhe mjedisore.

3. Hartimi i zgjidhjeve arkitektonike dhe inxhinierike

- Hartimi i konceptit arkitektonik dhe integrimi me natyrën për çdo pikë të përzgjedhur;
- Zgjidhje teknike për strukturën mbajtëse, bazamentin, qasjen dhe sigurinë e vizitorëve;
- Përzgjedhja e materialeve dhe formave ndërtimore që minimizojnë ndikimin vizual dhe mjedisor;
- Përgatitja e skicave teknike dhe modeleve vizuale (3D, fotomontazhe).

Për realizimin e projektit studentët do të marrin pjesë në:

1. Lançimin e konkursit me AKZM dhe FAU-n

Qëllimi është prezantimi i strukturës së konkursit dhe koordinimi mes palëve.

1. **Takimin ndërmjetësues** (Takim me 3 fituesit përpara lidhjes së kontratës së shërbimit për zhvillimin e mëtejshëm të projektit)
2. **Takimin përfundimtar** (Lidhja e kontratës së shërbimit)
3. **Prezantim publik** (Prezantim publik i 3 projekteve më të mira me panel dhe jurinë)
4. **Ndjekja e implementimit të projekteve pilot** (Diskutim mbi fazat e zbatimit dhe rekomandime për vijimësinë)

Periudha për konkursin “Kullat e vrojtimit” do të shtrihet në 22 javë.

3.2. SHËRBBIMET E KËRKUARA DHE DOKUMENTAT PËR DORËZIM

Në mënyrë të detajuar, më poshtë paraqitet struktura që duhet të përmbajë projekti i hartuar nga studentët, i cili duhet të respektojë dispozitat e Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të projektimit në mjedise natyrore të mbrojtura, si dhe kërkesat e Termave të Referencës.

FAQE | 12

A. Projekt ideja fillestare duhet të përfshijë të dhënat e mëposhtme: (Format A0 – shkallë e lexueshme)

- Analizë e gjendjes ekzistuese të terrenit për secilën pikë të identifikuar si potenciale;
- Identifikimi dhe dokumentimi grafik (harta, foto) i vendndodhjeve të propozuara për ndërhyrje;
- Vlerësimi i stabilitetit të vendndodhjes dhe aksesueshmërisë;
- Hartimi i projektit arkitektonik për çdo kullë të propozuar;
- Propozimi i zgjidhjeve teknike për bazamentin dhe strukturën mbajtëse;

B. Projekti arkitektonik/ Projekt Zbatimi – (Format A0 – shkallë e lexueshme)

- Analiza e terrenit dhe vlerave peizazhore të secilës pikë;
- Planimetri dhe planvendosje e përgjithshme e strukturave në terren;
- Studimi arkitektonik;
- Detaje konstruktive dhe prerje teknike të elementëve të ndërtimit;
- Zgjidhje për sistemimin horizontal të qasjes dhe skema të lëvizjes;
- Materialet e propozuara për ndërtim;
- Pamje teknike dhe pamje tre-dimensionale të përfshira në peizazh;
- Fotomontazhe dhe ilustrime vizuale për çdo vendndodhje;
- Zgjidhje për sinjalistikën orientuese dhe interpretimin mjedisor.

C. Relacioni teknik (formati A4), i cili duhet të përmbajë:

- Përshkrimin e gjendjes ekzistuese, analizat e kryera sipas profilit të ekspertëve dhe konkluzionet e arritura nga studimi;
- Përshkrimin e konceptit të projektit, parametrat e projektimit, standardet e përdorura, metodologjia, llogaritjet e kryera;
- Përshkrimin dhe zgjidhjen e veçantë arkitektonike;
- Përshkrimin e materialeve të përzgjedhura dhe sinjalistikës;
- Konkluzionet, rekomandimet dhe pritshmëritë e projektuesit/grupit të projektimit.

4. REALIZIMI I STUDIMIT

4.1 PLANIFIKIMI DHE DORËZIMET

4.1.1. Periudha e fillimit

Periudha e parashikuar e fillimit për hartimin e koncept ideve do të jetë në fund Nëntor 2025.

4.1.2 Periudha e përfundimit e parashikuar ose kohëzgjatja

Kohëzgjatja e konkursit do të jetë 22 javë nga data e fillimit.

4.1.3. Planifikimi - përfshirë periudhën e lançimit të konkursit.

Nr.	Faza	Rezultati	Periudha	Afati
1	Faza I	Thirrja dhe lancimi i konkursit	20 – 26 Nëntor	
		Afati i regjistrimit dhe pyetjeve	26 Nëntor – 09 Dhjetor	2 javë
		Afati i dorëzimit të projekt idesë	09 Dhjetor – 02 Mars	12 javë
2	Faza II	Ekspozita me projektet	03 – 12 Mars	2 javë
		Shpallja e 3 projekteve fituese	14 Mars	
3	Faza III	Lidhja e kontratës me 3 fituesit	17 Mars	6 javë
		Takim ndërmjetësues	10 Prill	
		Dorëzimi i projekt zbatimit	30 Prill	
		Prezantim publik me 3 fituesit	04 Maj	

4.2. RAPORTIMI

4.2.1. Përmbajtja, gjuha, paraqitja/ afati i komenteve, numri i kopjeve të raportit.

Projekti së bashku me studimet dhe anekset përkatëse të tij duhet të jenë në 1 (një) CD me të gjitha materialet në formatet përkatëse (jpg, pdf, word, excel etj.). Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Projekti duhet të dorëzohet edhe në formë elektronike në adresën zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. (info@akzm.gov.al) sipas afatit të përcaktuar. Për prezantimin e ekspozitës projektet do të printohen në format A0 dhe do të ekspozohen pranë ambjeteve të UPT.

4.3. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

4.3.1. Përcaktimi i treguesve

Autoriteti Kontraktor përgjegjës për menaxhimin e këtij konkursi është Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM). Një grup i jurisë së projektit do të emërohet në emër të AKZM. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është përfutuesi i këtij projekti dhe si e tillë duhet të jenë e përfshirë në të gjitha konsultimet për këtë konkurs.

4.3.2. Angazhimi gjatë implementimit

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) kërkon që 3 studentët që do të zgjidhen si 3 projektet më të mira, të angazhohen gjatë fazës së implementimit sa herë të jetë nevoja për sqarime, korrigjime apo detajime të projektit që mund dhe duhet të ishin parashikuar dhe bërë gjatë hartimit të projektit.

4.3.3. Lehtësirat për Fituesit e Projektit dhe Aksesit në Informacion

Një mundësi reflektimi dhe kontributi për studentët e arkitekturës, vizioni dhe puna e të cilëve do të reflektohet me tre projekte fituese, të aplikuara në 3 vendodhje të ndryshme.

Tre çmimet e para do të fitojnë 3 kontrata pune **6 mujore** me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, (AKZM), mundësuar falë mbështetjes së projektit **EU4Nature** financuar nga BE dhe SIDA dhe zbatohet nga UNDP në bashkëpunim me AICS.

AKZM-ja do të sigurojë akses në të gjitha informacionet relevante ekzistuese, harta, studime, modele, dokumentet ligjore etj., që disponon, menjëherë dhe pa kosto.

4.3.4. Takimet teknike dhe mes palëve të interesuara

Aktivitetet e mësipërme të listuara do të bëhen në konsultim me AKZM-në përmes një takimit ndërmjetësues. Projekti për **“Kullat e Vrojtimit në rrjetin e zonave të mbrojtura”**: – **Inteligjenca Natyrore, Artificiale & Kolektive** duhet të miratohet nga autoriteti(et) kompetent(e), në përputhje me Ligjin Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”, i ndryshuar. Dokumentet e projektit duhet të vihen në dispozicion të publikut.

4.3.5. Transferimi i njohurisë

3 Studentët fitues do të punojnë në bashkëpunim me AKZM, me qëllim që ato të marrin pjesë aktivisht dhe intensivisht gjatë gjithë procesit të hartimit të projektit, për të dhënë kontribut por edhe për të rritur kapacitetet e personave që do të punojnë për zbatimin e projektit.

4.3.6. Konfidencialiteti

Dokumentet dhe të dhënat që do të vihen në dispozicion të studentëve nga AKZM, apo institucione të tjera publike, duhet të konsiderohen konfidenciale dhe nuk duhet të transmetohet tek palët e treta.

5.REFERENCA | SHTOJCA

ANEKS 1: Harta e pozicionimit të pikave të propozuara për Kulla Vrojtimi.